

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit Gazeta e përditshme “Tribuna Shqiptare” me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim J.I. kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson me autorizim F.M. për shkak të pagesës të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike, III.C.nr.608/2013, të datës 26.10.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 10.05.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike, III.C.nr.608/2013, i datës 26.10.2015, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar nën paragrafin I. të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Gazeta e përditshme “ Tribuna Shqiptare” sh.p.k me seli në Prishtinë dhe e ka detyruar të paditurin Komuna e Lipjanit, që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2.173,26 € në emër të pagesës së borxhit që rrjedh nga faturat e nënshkruara nga palët ndërgjyqjësë me kamatë ligjore duke llogaritur nga dita e parashtrimit të propozimit për përmbarim e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin parativ (vullnetar) prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në paragrafin II të dispozitivit është refuzuar pjesa e kërkesëpadisë së palës paditëse në shumën prej 4.065,80€ si e pabazuar. Ndërsa në paragrafin III është detyruar pala e paditur që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore ti paguaj palës paditëse shumën prej 235.00€, po ashtu në afatin kohor prej 7 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, Komuna e Lipjanit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar, ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit ose ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen t’ia kthej Gjykatës Themelore në Prishtinë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi Gazeta e përditshme “ Tribuna Shqiptare” me datë 09.10.2013,ka parashtruar pranë kësaj gjykate propozimin për përmbarimin lidhur me pagesën e borxhit në shumën e përgjithshme prej 6.239,09 € ndaj palës debitore Komuna e Lipjanit. Me aktvendimin e E.nr. 950/13 të dt.10.09.2013, ka lejuar përmbarimin. Debitori ka paraqitur kundërshtimin ndaj aktvendimit për lejimin e përmbarimit dhe mbi këtë bazë kjo çështje ka kaluar në procedurë kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e lëndës, fatura me nr.2010/287 e datës 30.09.2010 me vlerë prej 748,20€,fatura me nr.2010/353 e datës 31.10.2010 me vlerë 552,00€,fatura me nr.2010/362 e datës 30.11.2010 në vlerë prej 156,60€,fatura me nr.2010/414 e datës 28.12.2010 në vlerë prej 217,50€,fatura me nr.2011/004 e datës 11.01.2011 në vlerë prej 174,00€, fatura me nr.2011/047 e datës 31.01.2011,në vlerë prej 156,60 € dhe fatura me nr.2011/154 e datës 30.06.2011 në vlerë prej 198,36 € të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 2.173,26 €, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me këto fatura pasi që ka konstatuar se të njëjtat janë të nënshkruara nga të dy palët ndërgjyqëse dhe këto kërkesa nuk janë të parashkruara. Ndërsa ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në shumë prej 4,065.80 € pasi ka gjetur se kërkesat e paditësit janë parashkruar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 262 par.1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar “*kreditori në marrëdhënien detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, kurse debitori është i detyruar që ta përmbushë detyrimin në tërësi*”. Në rastin konkret rezulton se i padituri, duke mos e kryer detyrimin e tij që ka rrjedhur nga shërbimet e pranuar i ka mbetur borxh paditësit shumën e përgjithshme prej 2.173,26 €, me ç ‘rast ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitori. Prandaj duke u nisur nga fakti se i padituri me mospagimin e faturave i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartë cekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie të vazhdueshme afariste për ofrimin e shërbimeve të publikimit në bazë të kontratës Nr. 01-12, dt. 08.04.2010. Nga faturat e administruara si provë dhe nga publikimet në gazetë vërtetohet fakti se paditësja me publikimin në gazetë ka kryer obligimet ndaj të paditurës, duke ia dërguar faturat për shërbimet e kryera andaj në kuptim të nenit 42 par 3 i LMD-së, andaj edhe është krijuar raporti detyrimor. Ndërsa e paditura edhe për kundër faktit të kryerjes së shërbimeve të publikimeve në gazetë, nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj paditëses sipas shërbimeve të kryera dhe faturave të pranuar.

Pretendimet e përfaqësuesit të së paditurës se faturat nuk janë dorëzuar te e paditura respektivisht se ato janë fiktive pasi nuk janë të nënshkruara nga personi i autorizuar i të paditurës dhe nuk janë të protokolluara, gjykata i konsideroi si të papranueshme sepse të njëjtat nuk mbështeten në prova dhe janë të paqëndrueshme pasi pranimi i faturave nënkupton edhe pranimin e obligimit për pagesë. Gjykata e Apelit duke u bazuar në Nenin 104.1 të Ligjit për procedurën kontestimore (Ligji Nr.03/L-006) vlerëson se dorëzimi i faturave është bërë në mënyrë të rregullt, ndërsa mos-kontestimi i faturave nga ana e të paditurës brenda afatit ligjor, nënkupton pranim të faturës dhe obligimit që rrjedh nga ajo faturë. Gjykata nga faturat të cilat gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se të njëjtat përputhen me publikimet në gazetë andaj vlerëson se pretendimet se publikimet dhe faturat ishin fiktive janë të paqëndrueshme.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr. 09/2016, dt. 10.05.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.